



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR APLIKIM PROJEKTESH I PËR VITIN 2025

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shpall këtë thirrje për Aplikime Projektesh I për vitin 2025, për institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Subjektet e interesuara (më poshtë subjekti aplikues), ftohen që brenda **datës 09.07.2025, ora 12:00** të paraqesin dorazi/postë, në zyrën e protokollit të AMA-s, të gjithë dokumentacionin e propozimit për projektet në drejtimet e mëposhtme :

1. Drejtimi: Dezinformimi në mediat shqiptare, faktor mosbesueshmërie në procesin e informimit.

Qëllimi: Në mediat tradicionale dhe ato të reja, dezinformimi është realitet shqetësues që sjell derivate të reja ndikimesh negative mbi shoqërinë dhe kryesisht në procesin informues. Në praktikën raportuese në mediat audiovizive dhe ato të reja në Shqipëri vërehen raste të shpeshta dezinformimesh. Dezinformimi sjell pasoja mbi individë të pafajshëm, grupe të pambrojtura sociale apo edhe entitete të ndryshme shoqërore. Raportimet dezinformuese në shumë raste kanë shkaktuar pasoja tronditëse në shëndetin mendor të publikut. Ky studim krijon mundësinë e pasjes së një pasqyre për cedimet deontologjike në praktikën e hapësirës kohore të një viti, në raportimet dhe procesin informues në skenën mediatike të vendit. Kategorizimi në kapituj i “antologjisë së rasteve” specifikon tipologjinë e fenomenit në realitetin mediatik shqiptar, karakteristikat që ekspozojnë përgjegjësinë dhe detyrimet e parespektuara deontologjike nga entiteti i reporterëve dhe editorët e mediave. Kështu krijohet premisa për një ndjekje të tillë periodike dhe krijimin e një historiku që ndikon në jetën e studimeve universitare për mediat shqiptare dhe dukuritë dezinformuese sikundër edhe për kategoritë e ndryshme të profesionistëve në spektrin multimedial të vendit.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një studim mbi “Antologjinë e rasteve dezinformuese në edicionet dhe hapësirën informative në mediat audiovizive”.
- Aktivitete/ tryeza pune, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e këtij studimi analitik dhe do të diskutohen ide dhe pikëpamje që lidhen me të.
- Botimi me ISBN, ku do të përfshihen studimi analitik dhe dinamika e takimeve në qytete.

Fondi në dispozicion nga AMA për propozime në këtë drejtim është deri në masën 1,000,000 lekë.

2. Drejtimi: Dezinformimi në hapësirën digjitale shqiptare, një analizë e përditësuar e sfidave dhe zgjidhjeve.

Qëllimi: Informacioni dhe konsumimi i përmbajtjeve mediatike në hapësirën virtuale merr një rëndësi të jashtëzakonshme në jetën e një individi në Shqipëri, në kushtet kur pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare është pjesë e kësaj hapësire. Dezinformimi është një nga problematikat për të cilën dhe Bashkimi Evropian ka dhënë sugjerimet e tij për ta luftuar. Një pjesë e mediave audiovizive në Shqipëri kontribuojnë në këtë hapësirë digjitale nëpërmjet profileve të tyre në rrjetet sociale, duke u bërë kështu edhe një objekt i detyrueshëm shkencor për t’u analizuar në këtë këndvështrim. A ka dezinformim? Nëse po, cili është cikli

i tij? Ka dezinformim të jashtëm apo të brendshëm? Ku shfaqet më shumë? Si shfaqet në hapësirën digjitale? Cila është analiza e përditësuar dhe cilat janë sfidat? Çfarë mund të bëjnë aktorët në Shqipëri për ta luftuar atë? Këto janë disa nga pyetjet, përgjigjet e të cilave janë me rëndësi për të ndihmuar publikun, audiencat dhe përdoruesit e mediave në njohjen e situatës dhe mbrojtjen prej dezinformimit.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një analizë e thelluar shkencore me sfidat dhe zgjidhjet që paraqet problematika e dezinformimit në Shqipëri në hapësirën virtuale.
- Aktivitete/ tryeza pune, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e këtij studimi analitik dhe do të diskutohen ide dhe pikëpamje që lidhen me të.
- Botimi me ISBN i këtij studimi të thelluar shkencor.

Fondi në dispozicion nga AMA për propozime në këtë drejtim është deri në masën 1,000,000 lekë.

3. Drejtimi: Infodemia, dezinformimi në fushën mjekësore.

Qëllimi: Në epokën e informacionit digjital dhe rrjeteve sociale, përhapja e dezinformatave dhe lajmeve të rreme në fushën e shëndetësisë – e njohur si infodemi – paraqet një kërcënim serioz për shëndetin publik, besimin tek institucionet dhe vendimmarrjen individuale të informuar. Pandemia Covid-19 nxori në pah nevojën kritike për edukim mediatik dhe për forcimin e kapaciteve të aktorëve të medias për të promovuar informacion të verifikuar dhe bazuar në prova shkencore. Në këtë kuadër, synohet të zhvillohet dhe botohet një manual edukativ për gazetarët, profesionistët e medias dhe publikun e gjerë mbi rëndësinë e menaxhimit të infodemisë dhe informimit të saktë në fushën e shëndetit publik. Kjo do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve të medias dhe publikut mbi rreziqet e infodemisë. Gjithashtu, do të promovojë praktikën e gazetarisë së përgjegjshme dhe të bazuar në evidencë shkencore në raportimin shëndetësor dhe do të shërbejë si mbështetje për edukimin mediatik të publikut për të përballuar dezinformatat.

Produktet që duhet të realizojnë subjektet aplikuese:

- Një manual edukativ për gazetarët, profesionistët e medias dhe publikun e gjerë mbi rastet e dezinformimit në fushën e shëndetësisë.
- Aktivitete/ tryeza pune, në të paktën 6 qytete të vendit, ku do të parashtrihen gjetjet e këtij studimi analitik dhe do të diskutohen ide dhe pikëpamje që lidhen me të.
- Botimi me ISBN, ku do të përfshihen studimi analitik dhe dinamika e takimeve në qytete.

Fondi në dispozicion nga AMA për propozime në këtë drejtim është deri në masën 1,000,000 lekë.

MËNYRA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Kërkesa për projekt-propozimin dërgohet në rrugë postare, ose dorazi pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në pikën 3.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe.
3. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim është:
 - a) Kërkesë për miratim të projekti-propozimit;
 - b) Formatin e aplikimit sipas modelit në **aneksin 1**;
 - c) Jetëshkrimin profesional të grupit të punës që do të zhvillojë projektin;
 - d) Fotokopje të dokumentit të identifikimit të personit/personave që do të zhvillojë/zhvillojnë projektin;
 - e) Ekstraktin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit në Republikën e Shqipërisë (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë) - origjinal ose kopje e noterizuar, lëshuar brenda 3-mujorit të fundit nga dita e aplikimit.

- f) Dokumentin e regjistrimit në organin tatimor (NIPT)/Ekstrakt Historik QKB si dhe vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit.
 - g) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore i personave që do të zbatojnë projektin;
 - h) Informacion mbi financimin e projektit; (projekt-propozimi të jetë i shoqëruar me projektbuxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe **aneksin 1**)
 - i) Në planin buxhetor të projekt-propozimit, vetë subjekti aplikues, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetë financues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.
 - j) Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera të detyrimeve tatimore dhe vërtetim të sigurimeve shoqërore, të tre muajve të fundit nga data e aplikimit.
 - k) Vërtetim për numër llogarie bankare, në Lekë.
 - l) Deklaratë nga subjekti aplikues që nuk ka pranuar mjete nga burime të tjera financimi për të njëjtat aktivitete.
 - m) Informacion për kontributin dhe angazhimin e subjektit në fushën e medias dhe projektet e më përparshme që ka realizuar.
4. Mbi zarfin e aplikimit të shënohet “Thirrje për aplikim projektsh I, viti 2025” si dhe të shkruhen të dhënat e thirrjes (datë, titull i projektit, etj).
5. Autoriteti i Mediave Audiovizive financon vetëm zërat referencë në listën e publikuar si pjesë e kësaj thirrje. Zërat që nuk janë pjesë e kësaj liste, duhet të mbulohen nga vetë aplikuesi.

KËRKESA TË TJERA PËR APLIKUESIT

1. Subjektet që mund të paraqesin kërkesa për projekt-propozime pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, duhet:
 - a. Të jenë institucione dhe organizata joqeveritare;
 - b. Të jenë persona juridikë publikë;
2. Nuk mund të paraqesin projekt-propozime partitë politike, sindikatat apo organizatat politike.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive, nuk mbështet projekt-propozime që kanë lidhje pronësie direkt apo indirekt me OSHMA-të.
4. Subjektet të cilat kanë projekte në proces të mbështetur nga AMA, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekti.

Aplikimet e dorëzuara në protokollin e AMA-s, përtej datës dhe orës së përcaktuar si afat përfundimtar në këtë thirrje **data 09.07.2025, ora 12:00**, nuk do të merren në shqyrtim. AMA do të vijoje komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me subjektet aplikues, të cilëve iu vlerësohet aplikimi në përputhje me kërkesat e kësaj thirrje.

Në faqen zyrtare të AMA-s, gjeni rregulloren e brendshme “Mbi kriteret dhe procedurat për shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e projekteve”, në fushën e mediave audiovizive. (<https://ama.gov.al/wpcontent/uploads/2020/07/Vendim-nr.113-date-11.12.2023-P%C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-MbiKriteret-dhe-Procedurat-P%C3%ABr-Shqyrtimin-Miratimin-dhe-Zbatimin-e-Projekteve-t%C3%AB-AMAs.pdf>)

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë më, 28.05.2025

(Aneksi 1)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME
NË FUSHËN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE
FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE MBËSHTETJE**

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit: [.....]

Aplikanti (emri i organizatës që aplikon/partneri 1): [.....]

Statusi ligjor i organizatës që aplikon:

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

Pozita në organizatë: [.....]

Tel: [.....]

E-mail: [.....]

Kohëzgjatja e projektit: nga data/muaj/vit [.....] deri në datën/muaj/vit [.....]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [.....]

Fusha dhe tema e projektit: [.....]

Buxheti total: [.....]

Fondet e kërkuara nga AMA: [.....]

Informacion për bashkëfinancim (emri-shuma): [.....]

Partnerët e Projektit: [.....]

PJESA II: PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[.....]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [.....]

2. [.....]

3. [.....]

4. [.....]

5. [.....]

Lloji i aktiviteteve sipas fushës, p.sh. studime tregu, rritje e zhvillim audiencash, aktivitete trajnuese, hulumtime..etj, si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [.....]

2. [.....]

3. [.....]

4. [.....]

5. [.....]

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (*Maksimumi 5 rreshta*):

[.....]

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (*Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet*):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [.....]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblodhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si dhe organizatës që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit? Maksimumi 5 rreshta: [.....]

PJESA III: PARTNERËT (NËSE KA)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i organizatës tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Struktura. Përshkruani strukturën e organizatës duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Financimi. Si financohet organizata juaj dhe cili ishte buxheti i saj për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [.....]

Partneri 2

Emri organizatës: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

E-mail: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

Partneri 3

Emri i individit/organizatës: [.....]

Personi i kontaktit: [.....]

E-mail: [.....]

Adresa: [.....]

Faqja në internet: [.....]

PJESA IV: BUXHETI

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?

Plotëso: Tabelën për kostot financiare pjesë e kësaj Thirrje

TABELA E KOSTOVE FINANCIARE

Emri i subjektit aplikues:

Titulli i Projektit:

Koha e zbatimit: nga/deri

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë	TOTAL	AMA	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-
SHPENZIMET SIPAS AKTIVITETEVE DHE ZËRAVE PËRKATËS									
1	AKTIVITETI 1: Titulli...								
1.1									
1.2									
1.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 1			-	-				
2	AKTIVITETI 2: Titulli....								
2.1									
2.2									
2.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 2			-	-				
3	AKTIVITETI 3: Titulli....								
3.1									
3.2									
3.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 3			-	-				

4	AKTIVITETI 4: Titulli ...								
4.1									
4.2									
4.3									
	TOTAL AKTIVITET _ 4			-	-				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) lekë								
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+..) %								

Sqarim:

- Ju lutemi, të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë AMA-n dhe vetë subjektin aplikues), edhe si % e buxhetit total për projektin.

SKEDA INFORMATIVE E PROJEKTIT

Emri i subjektit aplikues:

Titulli i projektit:

Aktiviteti (Përshkrimi)	Qyteti	Periudha	Fusha/Gjinia	Nr. audiencës (parashikim)	Nr. personave të angazhuar (Pagesa honorar)	Partneri zbatues

Shënim:

- Ju lutem, shënoni **Aktivitetin** me të gjitha të dhënat që kërkohen.

Lista me zërat referencë që financohen nga AMA

	Zërat		
Nr.	I	Njësia	
	<i>Menaxhimi i projektit</i>		
1	Drejtues projekti	Ditë/Muaj	
2	Jurist projekti	Ditë/Muaj	
3	Asisent projekti	Ditë/Muaj	
4	Kordinator	Ditë/Muaj	
5	Moderator në fokus grupe	Aktivitet	
6	Moderator për tryezë konsultuese	Aktivitet	
7	Folës për prezantim studimi	Aktivitet	
8	Moderator konference	Aktivitet	
	II		
	Ekspertët		
1	Ekspert dizanjues	Faqe	
2	Ekspert për mbledhje të dhënash	Ditë/Muaj	
3	Ekspert për analizim të dhënash	Ditë/Muaj	
4	Ekspert statistike	Ditë/Muaj	
5	Ekspert për metodologjinë	Ditë/Muaj	
6	Ekspert i ftuar	Aktivitet	
7	Ekspert për shkrim raporti	Faqe	
8	Ekspert për ngritjen e treguesve	Faqe	
9	Ekspert monitorues	Ditë/Muaj	
10	Ekspert për dizenjimin e instrumenteve	Ditë/Muaj	
11	Ekspert financiar	Ditë/Muaj	
12	Ekspert i medias	Ditë/Muaj	
13	Ekspert trajnues	Ditë/Muaj	
14	Ekspert të specialiteve të ndryshme	Ditë/Muaj	
	III		
	<i>Studim, përkthim, trajnime</i>		
1	Redaktim libri	Faqe	
2	E drejta e autorit	Vepër	
3	Faqosje	Faqe	
4	Printim	Faqe	
5	Studiues	Ditë/Muaj	
6	Shtypshkrim	Faqe	
7	Redaktim studimi	Faqe	
8	Redaktim raporti	Faqe	
9	Pagesë për të intervistuarit	Person	
10	Anketues	Person	
11	Intervistues	Person	

12	Hartues pyetësori	Copë	
13	Përkthyes	Faqe	
14	Trajnues	Ditë/Muaj	
15	Lektor	Leksion	
16	Konsulent i jashtëm	Ditë/Muaj	
17	Materiale trajnimi	Person	
18	Realizues sondazhi në terren	Person	
	IV		
	<i>Salla për konferencë, prezantim, trajnim</i>		
1	Sistem fonie konference	Aktivitet	
2	Qira salle për trajnim/ Tiranë	Aktivitet	
3	Qira salle për prezantim/ Tiranë	Aktivitet	
4	Qira salle për organizim konference/ Tiranë	Aktivitet	
5	Qira salle për trajnim/ Rrethe	Aktivitet	
6	Qira salle për organizim konference/ Rrethe	Aktivitet	
7	Qira salle për prezantim/ Rrethe	Aktivitet	
	V		
	<i>Shpenzime operative</i>		
1	Dieta	Ditë	
2	Transport	Km	